



**VENDIM**

**Nr.82 Datë 04.11.2009**

**PER  
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR NDRYSHIMIN E LICENSËS  
NR.16, SERIA PV04P, LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË  
KOMISIONEREVE TË ERE-S, NR.39, DATË 22.07.2004 PËR  
SHOQËRINË “WTS ENERGJI” SH.P.K, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, neneve 10 dhe 15 pika 2 gërma “c” të “Rregullores për procedurat e licënsimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.11.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k, për ndryshimin e licensës Nr.16, Seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.39, datë 22.07.2004, për shoqërinë “WTS Energji” sh.p.k, të ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 26, datë 09.04.2009

**Dhe konstatoi se janë paraqitur ne përputhje me rregulloren për procedurat e licënsimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave”,:**

- Informacioni me shkrime ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licensës. (neni 15, pika 4, gërma “a”)
- Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar ndryshim license. (neni 15, pika 4, gërma “b”)

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për ndryshimin e licensës Nr.16, seria PV04P, leshuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s, Nr.39, datë 22.07.2004 për shoqërinë “WTS Energji” shpk, të ndryshuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve Nr. 26, datë 09.04.2009.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.